REPUBLIKA E KOSOVËS

ZYRA E AUDITORIT TË PËRGJITHSHËM

Nr. i Dokumentit: 21.6.1-2015-08

RAPORTI I AUDITIMIT

PËR PASQYRAT FINANCIARE TË MINISTRISË SË MJEDISIT DHE PLANIFIKIMIT HAPËSINOR PËR VITIN E PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2015

Prishtinë, qershor 2016

Auditori i Përgjithshëm i Republikës së Kosovës është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar, i cili me Kushtetutën dhe ligjet e vendit gëzon pavarësi funksionale, financiare dhe operative. Zyra e Auditorit të Përgjithshëm kryen auditime të rregullsisë dhe të performancës dhe për punën e vet i jep llogari Kuvendit të Kosovës.

Misioni ynë është që të kontribuojmë në menaxhimin e shëndoshë financiar në administratën publike. Ne kryejmë auditime në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtare të auditimit në sektorin publik si dhe me praktikat e mira evropiane.

Raportet e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm promovojnë drejtpërsëdrejti llogaridhënien pasi që ato ofrojnë bazë të qëndrueshme për t'u kërkuar llogari menaxherëve të çdo organizate buxhetore. Në këtë mënyrë ne po rrisim besimin në shpenzimin e fondeve publike dhe po luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe të palëve tjera të interesit në rritjen e përgjegjësisë publike.

Auditori i Përgjithshëm ka vendosur në lidhje me opinionin e auditimit dhe raportin mbi Pasqyrat Vjetore Financiare të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor në konsultim me Ndihmës Auditorin e Përgjithshëm, Ibrahim Gjylderen, i cili e ka mbikëqyrur auditimin.

Raporti dhe opinioni i lëshuar janë rezultat i auditimit të kryer nën menaxhimin e Drejtorit të Auditimit, Zukë Zuka, i mbështetur nga, Udhëheqësja e Ekipit, Mirlinda Beqiri dhe anëtarët, Refiqe Morina, dhe Hysen Boqolli.

TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje e përgjithshme 4

1 Pasqyrat vjetore financiare dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm 7

2 Qeverisja 11

3 Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli 16

Shtojca I: Qasja dhe metodologjia e auditimit 31

Shtojca II: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZAP 32

Shtojca III: Rekomandimet e vitit paraprak 34


Përmbledhje e përgjithshme

Hyrje

Ky raport përmbledh çështjet kryesore që dalin nga auditimi ynë i pasqyrave vjetore financiare të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor për vitin 2015 – i cili e përcakton Opinionin e dhënë nga Auditori i Përgjithshëm. Unë do të doja të falënderoja Ministrin dhe stafin e tij për ndihmën e tyre gjatë procesit të auditimit.

Ekzaminimi i pasqyrave financiare për vitin 2015 u ndërmor në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtarisht të auditimit në Sektorit Publik (SNISA). Qasja jonë ka përfshirë testet dhe procedurat, të cilat ne menduam se ishin të nevojshme për të arritur në një opinion lidhur me pasqyrat financiare. Qasja e ndërmarrë është paraqitur në Memon e Planifikimit të Auditimit, te muajit shtator 2015.

Auditimi ynë është fokusuar në (është dhënë në hollësi në Shtojcën I):



Niveli i punës së kryer nga Zyra e Auditorit të Përgjithshëm për të përfunduar auditimin për vitin 2015 pasqyron drejtpërsëdrejti cilësinë e kontrollit të brendshëm të zbatuar nga menaxhmenti.

Opinioni

Shtojca II shpjegon llojet e ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ana e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm.

Opinioni i Auditorit të Përgjithshëm është:

Opininion i Pamodifikuar

Pasqyrat financiare *paraqesin një pamje të drejtë dhe të vërtetë* në të gjitha aspektet materiale.

Theksimi i Çështjes


Ne tërheqim vëmendjen tuaj për faktin se projektet kapitale të ndërtuara për të riatdhesuarit dhe projektet e bashkë financuara me komunat nuk ishin tjetërsuar te përfituesit por ato ishin regjistruar si pasuri e Ministrisë. Derisa obligimet e papaguara për shpronësime kanë arritur vlerën totale prej 146 milion euro.

Formulimi i plotë i fjalëve është dhënë në hollësi në Pjesën 1.2 të këtij raporti varësisht prej lloji të opinionit.

Konkluzioni i përgjithshëm

Konkluzionet dhe rekomandimet tona kryesore janë:

Procesi i përgaditjes së PVF-ve është menaxhuar me disa gabime financiare dhe të prezantimit, të idenitifkuara gjatë auditimit.	Ministri duhet të sigurohet se procesi i përgatitjes së PVF 2016 të inkoporojë një rishikim menaxherial formal dhe efektiv dhe deklarata për PVF-të të nënshkruhet vetëm pasi janë zbatuar të gjitha veprimet e nevojshme (shih çështjen 1) .
Procesi i vetvlerësimit dhe përgjigja ndaj rekomandimeve të vitit paraprak ka nevojë për zhvillime të vazhdueshme për përmirësimin e organizatës.	Ministri duhet ta zbatojë një proces rigoroz për të siguruar që procesi i vetëvlerësimit dhe rekomandimet e vitit paraprak adresohen në mënyrë aktive ku çështjet/progreset kyçe i raportohen menaxhmentit në baza mujore (shih çeshtjen 2).
Aranzhimet e qeverisjes që kanë të bëjnë me menaxhimin e rrezikut janë të mangëta.	Ministri duhet të sigurojë që aranzhimet e Qeverisjes janë rishikuar në mënyrë kritike për t'u siguruar se janë bërë ndryshime adekuate në përmirësimin e aranzhimeve të llogaridhënies dhe raportimit menaxherial për ta ngritur efektivitetin operativ (shih çështjet 3 dhe 4).



Përgjigja e Ministrit – auditimi 2015

Ministri ka marrë në konsideratë dhe është pajtuar me të gjeturat e detajuara dhe konkluzionet e auditimit, si dhe është zotuar se do ti adresoj rekomandimet e dhëna.

1 Pasqyrat vjetore financiare dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm

1.1 Hyrje

Rishikimi ynë i Pasqyrave Vjetore Financiare (PVF-ve) merr parasysh pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë dhe saktësinë e informacionit të prezantuara në PVF. Ne gjithashtu e marrim parasysh deklaratën e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ (ZKA) dhe Zyrtari Kryesor Financiar (ZKF), kur PVF-të të dorëzohen në Qeveri.

Deklarata për prezantimin e PVF-ve përfshinë një numër të pohimeve në lidhje me pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë e informacionit në kuadër të PVF-ve. Këto pohime kanë për qëllim t'i ofrojnë Qeverisë sigurinë se të gjitha informatat relevante u janë ofruar për të siguruar se mund të ndërmerret një auditim gjithëpërfshirës.

1.2 Opinioni i Auditimit

Ne kemi audituar pasqyrat vjetore financiare të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH) për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2015, të cilat përfshijnë pasqyrën e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme, pasqyrën e krahasimit të shumave buxhetore dhe aktuale, shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare si dhe shpalosjet.

Sipas mendimit tonë Pasqyrat Vjetore Financiare prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale të pranimeve dhe pagesave, si dhe të buxhetit të realizuar të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2015, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik (të kontabilitetit në para të gatshme), Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime) dhe Rregullën financiare të MF, nr. 03/2013 për pasqyrat financiare të organizatave buxhetore.

Baza për Opinionin

Ne kemi kryer auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare. Sipas kërkesave etike, të cilat janë relevante për auditimin tonë të pasqyrave financiare të organizatave buxhetore në Kosovë, ZAP është i pavarur nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe përgjegjësitë tjera etike janë përmbushur në pajtim me këto kërkesa. Ne besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinionin tonë.

Theksimi i Çështjes

Ne tërheqim vëmendjen tuaj për faktin se projektet kapitale të ndërtuara për të riatdhesuarit dhe projektet e bashkë financuara me komunat nuk ishin tjetërsuar te përfituesit por ato ishin regjistruar si pasuri e Ministrisë. Derisa obligimet e papaguara për shpronësime kanë arritur vlerën totale prej 146 milion euro.

Përgjegjësia e Menaxhmentit dhe personave përgjegjës për Qeverisje dhe Pasqyrat Vjetore Financiare

Sekretari i Përgjithshëm i MMPH-së është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të pasqyrave financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme të modifikuar si dhe është përgjegjës për kontrolle të brendshme të tilla të cilat menaxhmenti i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare pa anomali materiale të shkaktuara qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë zbatimin e Ligjit nr.03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë i ndryshuar me Ligjin nr.03/L-221, Ligjin nr. 04/L-116 dhe Ligjin nr. 04/L-194.

Ministri është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Ministrisë.

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e pasqyrave vjetore financiare

Përgjegjësia jonë është që ta shprehim një opinion për pasqyrat vjetore financiare në bazë të auditimit tonë. Ne e kemi kryer auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit. Këto standarde kërkojnë që ne t'i përmbahemi kërkesave etike dhe ta planifikojmë dhe ta kryejmë auditimin për të marrë siguri të arsyeshme për atë nëse pasqyrat financiare nuk kanë keq deklarime materiale.

Objektivat tona janë që të marrim siguri të arsyeshme nëse pasqyrat vjetore financiare në tërësi nuk përmbajnë keq deklarime materiale qoftë nga mashtrimi ose gabimi, Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë i sigurisë, por nuk garanton se një auditim që kryhet në pajtim me SNISA-t do të zbulojë gjithnjë një keq deklarim material kur ajo ekziston. Keq deklarimet mund të lindin nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose së bashku, ato mund të pritet që të ndikojnë vendimet e përdoruesve të marra mbi bazën e këtyre pasqyrave vjetore financiare.

Auditimi përfshinë kryerjen e procedurave për të marrë dëshmi auditimi rreth shumave dhe shpalosjeve në pasqyrat financiare. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i auditorit, duke përfshirë këtu edhe vlerësimin e rreziqeve nga keq deklarimet materiale në pasqyrat financiare, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Në bërjen e këtyre vlerësimeve të rrezikut, auditori e konsideron kontrollin e brendshëm që është relevant në përgatitjen e pasqyrave financiare nga entiteti, në mënyrë që të dizajnojë procedura të auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat e

entitetit, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të entitetit.

Auditimi e përfshinë edhe vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e përllogaritjeve kontabël të bëra nga menaxhmenti, si dhe vlerësimin e prezantimit të pasqyrave financiare.

1.3 Rreziqet domethënëse në PFV

Përshkrimi

Në Memon tonë të planifikimit të auditimit, të datës 25.09.2015, është identifikuar një rrezik për PVF-të. Ky është cilësuar rrezik i keq deklarimit material, i cili mund të rezultojë në modifikim të opinionit ose në theksim të çështjes. Konsolidimi jo efektiv i procesit brenda MMPH-së mund të rezultojë në vlera materiale të pasurive dhe inventarit lidhur me agjencitë individuale të cilat nuk përfshihen në PVF të konsoliduara të MMPH-së. Procesi i konsolidimit të shënimeve financiare brenda ministrisë ka ndodhur. Megjithëkëtë, gjatë auditimit është vërejtur se klasifikimi i shpenzimeve nuk është bërë në mënyrë të duhur.

1.4 Pajtueshmëria me kërkesat për PVF dhe kërkesat tjera për raportim

MMPH kërkohet të veprojë në përputhje me kornizën e caktuar raportuese dhe kërkesat tjera për raportim. Ne kemi marrë parasysh:

- Pajtueshmërinë me Rregullën Financiare nr. 03/2014;
- Kërkesat e LMFPP-së nr. 03/L-048, i ndryshuar me Ligjin nr.03/L-221, Ligjin nr. 04/L-116 dhe Ligjin nr. 04/L-194;
- Pajtueshmërinë me Rregullën Financiare nr.02/2013;
- Raportet mbi kontrollet e brendshme, duke përfshirë raportin e vetvlerësimit;
- Kërkesat buxhetore; raportet mujore dhe tremujore duke i përfshirë këtu edhe pasqyrat nëntëmujore me kohë; raportet operative (të performancës) si dhe draft plani dhe plani përfundimtar i prokurimit më kohë; dhe
- Planin e veprimit për adresimin e rekomandimeve.

Në kontekst të PVF-ve, ne nuk kemi asnjë çështje për të ngritur në lidhje me këto. Çështjet e ngritura në memon tonë të auditimit të ndërmjetëm, të datës 19/11/2015 në lidhje me kornizën raportuese janë adresuar nga Menaxhmenti.

Në draft Pasqyrat Financiare ishin të nevojshme disa korigjime financiare dhe ne kemi dhënë edhe disa sugjerime të tjera për të përmirësuar shpalosjet përshkruese dhe për të siguruar plotësinë e shpalosjeve si në vijim:

- Në Pasqyrën e Pranimeve dhe Pagesave në Para të Gatshme nuk ishte bërë ndarja e pagesave nga palët e treta;
- Vlera e depozitave në mirëbesim sipas shënimeve të SIMFK-së nuk është e harmonizuar me vlerën e parave në llogarinë bankare. Sipas ministrisë, gjatë këtij viti në bashkëpunim me thesarin janë duke u identifikuar mos harmonizimet. Në auditimin e përkohshëm për vitin 2016 do te rishikohet progresi i arritur ; dhe
- Regjistri i pasurisë në SIMFK është mbivlerësuar për shkak të keq klasifikimeve si dhe mos bartjes së pronësisë në komunat projektet e të cilave i ka financuar Ministria.

Të gjeturat më lart tregojnë që përgatitja e PVF -ve është menaxhuar në mënyrë jo të duhur. Pika e pare është korrigjuar nga ZKF brenda afatit të paraparë ligjor ndërsa të gjeturat tjera kanë mbetur të pandryshuara.

Në kontekst të kërkesave tjera për raportim të jashtëm, ne kemi identifikuar mos pajtueshmërinë si në vijim:

- Mungonte raportimi i progresit në Ministrinë e Financave (MF) të Programit për Investime Publike (PIP). Pas vizitës sonë në fazën e parë të auditimit, MMPH ka përgatitur një lloj raporti i cili nuk përmban të gjitha dhënat e duhura; dhe
- Barazimet mujore për të hyrat nuk janë bërë që nga qershori i vitit 2015.

DEKLARATA E BËRË NGA ZKA DHE ZKF

Marrë parasysh çka u tha më lart, Deklarata e bërë nga ZKA dhe ZKF, me rastin e dorëzimit të draft PVF-ve në Qeveri, mund të konsiderohet e saktë përveç mangësive në regjistrimin e pasurisë dhe mosharmonizimeve për depozitat. Në kontekst të kërkesave tjera për raportim të jashtëm, nuk kemi çështje për të ngritur në lidhje me këto.

1.5 Rekomandimet

Rekomandimi 1 - **Prioriteti i lartë** - Ministri duhet të sigurojë se janë vendosur procese efektive për të konfirmuar që plani i hartimit të PVF 2016 i adreson të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me pajtueshmërinë. Kjo gjithashtu duhet të përfshijë rishikimin e draft PVF-ve nga menaxhmenti, me fokus të veçantë në fushat me rrezik të lartë dhe/ose fushat ku janë identifikuar gabime në vitet e mëparshme. Deklarata e bërë nga ZKA dhe ZKF nuk duhet të dorëzohet përveç nëse ndaj draft PVF janë aplikuar të gjitha kontrollet e nevojshme.

2 Qeverisja

2.1 Hyrje

Aranzhimet efektive të qeverisjes janë thelbësore për MMPH-ne që të menaxhojë në mënyrë të suksesshme sfidat me të cilat përballet dhe të sigurojë ofrimin e shërbimeve më të mira në dobi të taksapaguesve dhe të shfrytëzuesve tjerë të shërbimeve.

Një mjet kyç në mbështetje të qeverisjes efektive është zbatimi i rekomandimeve të auditimit pasi kjo tregon se menaxhmenti është duke u munduar t'i zhvilloj proceset ekzistuese dhe kontrollet. Në mënyrë të ngjashme, lista kontrolluese e vetvlerësimit që plotësohet nga të gjitha organizatat buxhetore siguron një kornizë për zhvillimin e aranzhimeve të zgjeruara të qeverisjes. Është e rëndësishme që përgjigjet e dhëna nga një organizatë individuale buxhetore të jenë të mbështetura nga dëshmitë përkatëse. Prandaj, ne e kemi aplikuar një qasje konsistente në të gjitha auditimet për ta përcaktuar cilësinë e listave kontrolluese të plotësuara për vetëvlerësim dhe për ta vlerësuar saktësinë e gjendjes së paraqitur mbi qeverisjen në Kosovë.

- Pjesa tjetër e rishikimit të aranzhimeve të qeverisjes e pasqyron një shqyrtim të: fushave të aranzhimeve të qeverisjes ku nevojiten përmirësime të rëndësishme dhe ku ne besojmë se rekomandimet tona mund të gjenerojnë përmirësime pozitive, duke e përfshirë edhe shqyrtimin e sistemit të Auditimit të Brendshëm; dhe
- Fushave të menaxhimit financiar dhe kontrollit të identifikuara përmes punës sonë të auditimit, duke përfshirë punën specifike të drejtuar në çështjet e pajtueshmërisë në sistemet kyçe të te hyrave dhe shpenzimeve (këto fusha janë shqyrtuar në kapitullin 3 të këtij raporti.

2.2 Konkluzioni i përgjithshëm mbi qeverisjen

Ekziston një numër i dobësive të qeverisjes brenda MMPH-së veçanërisht në lidhje me menaxhimin e rrezikut. Lista kontrolluese e vetvlerësimit , e plotësuar nga ZKA, e pasqyron këtë situatë vetëm pjesërisht. Aranzhimet tjera të cilat do ta mbështesnin zhvillimin e qeverisjes, si përgjigjja efektive ndaj rekomandimeve të auditimit dhe operimi i një sistemi i auditimit të brendshëm të cilësisë së lartë, mund te jenë me efikase.

2.3 Rekomandimet e vitit paraprak

Raporti ynë i auditimit për PVF-të të vitit 2014 të MMPH-se ka rezultuar me 17 rekomandime kryesore. Ministria ka përgatitur Planin e Veprimit ku paraqitet mënyra se si do të implementohen të gjitha rekomandimet.

Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2015, 11 rekomandime janë implementuar pesë janë adresuar dhe një nuk është adresuar ende. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrës se si janë adresuar ato, shihni Shtojcën III.

Çështja 2 – Implementimi i rekomandimeve nga viti paraprak – Prioritet i lartë

E gjetura	MMPH ka shënuar progres në implementimin e rekomandimeve të vitit të kaluar, megjithatë pesë prej rekomandimeve janë ende në proces ndërsa një ende nuk është implementuar. Sidomos kjo është e vërejtur tek prokurimi dhe klasifikimi i shpenzimeve. MMPH ka ndjekur një proces formal për të menaxhuar dhe monitoruar mënyrën e implementimit të rekomandimeve të Auditorit të Përgjithshëm (AP), megjithatë ende mbesin çështje për tu adresuar.
Rreziku	Mos implementimi në tërësi i rekomandimeve është ndikuar nga kontrollet e pa mjaftueshme në sistemet financiare kyçe, të cilat kanë reflektuar që disa të gjetura të përsëriten nga viti në vit. Mos përfundimi i projekteve disa vjeçare tregon për vlerën e dobët për para në praktikat e prokurimit. Kjo dhe vlera e lartë e llogarive të arkëtueshme dhe të obligimeve të pa paguara janë shqetësuese.
Rekomandimi 2	Ministri duhet të sigurojë që është zbatuar plani i veprimit, i rishikuar, i cili i përcakton saktë afatet kohore për implementim e rekomandimeve të bëra nga AP, me stafin përgjegjës të identifikuar, duke u fokusuar fillimisht në fushat më të rëndësishme.

2.4 Lista kontrolluese e vetvlerësimit të MFK-së

Ministria e Financave ka hartuar një listë të detajuar të vetvlerësimit për organizatat buxhetore për të mbështetur aranzhimet efektive të qeverisjes. Për të gjitha auditimet e ndërmarra, ne kemi testuar cilësinë e pyetësorëve të vetvlerësimit të MFK-së të dorëzuara në Ministri, duke vlerësuar nga një pyetje kyçe në secilën komponentë të listës kontrolluese. Ne kemi përmbledhur të gjeturat tona për MMPH-në më poshtë dhe përmbledhja e punës sonë në të gjitha auditimet do të konsolidohet në Raportin Vjetor të Auditimit të ZAP-it. Kjo nuk ka për qëllim të japë koment për cilësinë e tërë pyetësorit të dorëzuar të vetvlerësimit por do ta japë gjendjen për një numër të pyetjeve kyçe për ti mbështetur përpjekjet e Ministrisë së Financave në rritjen e efektivitetit të procesit dhe në zhvillimin e sistemit të MFK-së në tërësi.

Çështja 3 – Lista kontrolluese e vetvlerësimit – Prioritet i lartë

E gjetura

Si pjesë e auditimit tonë, i kemi shqyrtuar gjashtë pyetje kyçe të pyetësorit të vetvlerësimit në lidhje me pesë komponente. Për pyetjet e shqyrtuara kemi gjetur se:

1. Proceset e vendosjes së objektivave strategjike (përfshirë ndërlidhjen me palët e interesit si dhe sigurimin e strategjisë me kosto të plotë) konsiderohen si të vendosura nga MMPH;
2. Procedurat e duhura për menaxhim të rrezikut nuk janë vendosur dhe kjo është trajtuar në hollësi në nënkapitullin 2.5.1; dhe
3. Lidhjet në mes të planit të prokurimit dhe buxhetit si dhe përpilimi i raporteve adekuate në baza të rregullta kohore konsiderohen si të vendosura nga MMPH dhe dëshmitë që na janë dhënë e mbështesin këtë konkluzion edhe pse raportet nuk janë përpiluar gjithmonë në baza të rregullta kohore.

Për më shumë, veprimi i ndërmarrë për adresimin e çështjeve të identifikuara nga vetëvlerësimi i vitit 2014 është i limituar. Kjo situatë ka ndodhur për shkak të mungesës së qartësisë brenda MMPH-së që ka të bëjë me rëndësinë e kësaj liste kontrolluese dhe me atë se kush është zyrtari përgjegjës që i përdorë këto mekanizma për t'i mbështetur përmirësimet operative.

Rreziku

Aranzhimet e dobëta të qeverisjes i dobësojnë proceset strategjike dhe operative dhe e zvogëlojnë cilësinë e shërbimeve të ofruara për qytetarët përmes aktiviteteve joefikase dhe joefektive.

Rekomandimi 3

Ministri duhet të sigurojë se është zbatuar një rishikim për plotësimin e listës kontrolluese të vetvlerësimit dhe që është bërë adresimi i fushave me dobësi në mënyrë pro aktive. Duhet të aplikohet një mekanizëm i rishikuar për ta konfirmuar saktësinë e listës kontrolluese si dhe për të siguruar dokumentacionin mbështetës.

2.5 Rishikimet specifike të qeverisjes

Puna jonë në fusha të veçanta të aranzhimeve të qeverisjes është bazuar përmes planifikimit të auditimit, duke marrë parasysh kontekstin brenda të cilit MMPH operon dhe sfidat me të cilat përballet.

2.5.1 Vlerësimi i rrezikut

Të gjitha organizatat buxhetore pritet të zbatojnë vlerësimin e rrezikut. Udhëzimet e përcaktuara në Doracakun për menaxhim financiar dhe kontrolle (MFK) kërkojnë që çdo organizatë të përpiloj një liste rreziku ndaj të cilëve ekspozohet arritja e objektivave të organizatës, regjistri i rrezikut të jetë i kompletuar për të mbështetur menaxhimin efektiv operacional dhe strategjik.

Çështja 4 - Kërkesa për menaxhimin e rrezikut- Prioritet i lartë

E gjetura	Pyetësori i vetvlerësimit të plotësuar nga ZKA ka vërtetuar se sistemet e kërkuara të menaxhimit të rrezikut nuk ishin ende funksionale. Kjo situatë ka ndodhur për shkak se në organizatë mungonte një qasje sa i përket identifikimit të rreziqeve dhe listimit të tyre siç kërkojnë rregullat.
Rreziku	Mungesa e menaxhimit efektiv të rrezikut do të zvogëlojë cilësinë e shërbimeve pasi çështjet e brendshme dhe të jashtme që ndikojnë në këtë fushë nuk adresohen në kohën e duhur. Kjo për shkak se veprimet e nevojshme për të parandaluar ose evituar ndikimin e çështjeve të tilla nuk do të ndërmerren në mënyrë të planifikuar dhe sistematike.
Rekomandimi 4	Ministri duhet të sigurojë se është deleguar përgjegjësia e drejtpërdrejtë për menaxhimin e rrezikut tek zyrtarët përkatës dhe të sigurojë raportim mujor për zbatimin e kërkesave në këtë fushë dhe për rreziqet që janë duke u menaxhuar.

2.6 Sistemi i auditimit të brendshëm

Njësia e Auditimit të Brendshëm (NJAB) operon me tre anëtarë të stafit - Drejtori i NJAB dhe dy auditor. Për të kryer një auditim efektiv nevojitet një program gjithëpërfshirës të punës i cili reflekton rreziqet financiare dhe rreziqet e tjera të MMPH-se dhe ofron siguri të mjaftueshme mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm. Ndikimi i produkteve të Auditimit të Brendshëm duhet të gjykohet nga rëndësia që i jep menaxhmenti adresimit të rekomandimeve si dhe nga mbështetja dhe sfida të ofruara nga një Komitet efektiv Auditimi.

Komiteti i ri i auditimit është themeluar në Prill, 2015 dhe kishte mbajtur disa takime gjatë vitit, në takimet e mbajtura janë diskutuar çështjet për implementimin e rekomandimeve të dhëna nga ZAP-i dhe NJAB-së.

NJAB kishte përgatit planin vjetor të auditimit dhe planin strategjik për periudhën tre vjeçare (2015-2017) i cili është aprovuar nga menaxhmenti i ministrisë. NJAB kishte arritur ti përfundoj të gjitha auditimet e planifikuara dhe një raport lidhur me implementimin e rekomandimeve të vitit paraprak si dhe kishte përgatitur raporte informative sipas kërkesave të menagjmentit të Ministrisë.

Bashkëpunimi mes menaxhmentit të Ministrisë dhe Auditimit të Brendshëm është në funksion, kjo vërehet me takimet që kanë realizuar si dhe planit të veprimit të aprovuar nga menaxhmenti pas çdo raporti final. Në të njëjtën kohë menaxhmenti ishte angazhuar që të bëhet edhe monitorimi i planit të veprimit për të konfirmuar nëse rekomandimet e AB po respektohen.

Auditimet e brendshme kanë përfshirë fusha me rëndësi për veprimtarinë dhe objektivat e organizatës.

Rekomandimi:

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

3 Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli

3.1 Hyrje

Puna jonë për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin (MFK) jashtë fushave të Qeverisjes të përmendura në kapitullin dy, pasqyron punën e detajuar të ndërmarrë për sistemet e të hyrave dhe shpenzimeve. Si pjesë e kësaj ne konsiderojmë menaxhimin e buxhetit, çështjet e prokurimit dhe të burimeve njerëzore si dhe pasuritë dhe detyrimet.

3.2 Konkluzioni për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin

Sa i përket MMPH-së, prokurimi i projekteve te reja mbetet për shqetësim, për faktin që këto vështirësi reflektojnë drejtpërdrejtë në obligimet ndaj projekteve shumëvjeçare, të stërzgjatura dhe që ende nuk kanë përfunduar. Në kontekst të sistemeve financiare, kontrollet mbi të hyrat në përgjithësi janë të forta dhe janë duke u zbatuar në mënyrë efektive duke përjashtuar të hyrat që mblidhen nga departamenti i ujërave të cilat edhe përkundër legjislacionit të ri sekondar arkëtimi i tyre mbetet shqetësim.

Kontrollet mbi një sërë fushash të shpenzimeve kërkojnë përmirësim. Fushat kryesore ku nevojiten më shumë përmirësime janë realizimi i buxhetit dhe prokurimi. Përveç kësaj, edhe çështjet tjera si menaxhimi i personelit lidhur me kontratat për shërbime të veçanta, menaxhimi i pasurisë dhe rritja e obligimeve të papaguara mbesin të kenë vëmendjen e shtuar.

3.3 Planifikimi dhe Realizimi i Buxhetit

Ne i kemi shqyrtuar burimet e fondeve buxhetore për MMPH-në, shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike si dhe të hyrat e arkëtuara. Kjo është paraqitur në tabelat e mëposhtme:

Tabela 1. Burimet e fondeve buxhetore – realizimi ndaj buxhetit (në €)

Përshkrimi	Buxheti Fillestar	Buxheti Final	2015 Realizimi	2014 Realizimi	2013 Realizimi
Burimet e Fondeve:	38,353,185	38,732,279	38,126,445	44,967,147	46,790,254
Granti i Qeverisë -Buxheti	36,356,435	35,997,019	35,781,311	42,501820	44,236,542
Huamarrja	1,996,750	1,996,750	1,756,619	1,945,368	1,250,688
Donacionet e jashtme	0	738,510	588,515	519,960	592,024

Buxheti final është më i lartë se buxheti fillestar për 379,094€. Kjo rritje është rezultat i donacioneve vendore dhe të jashtme, si dhe ndryshimeve të aplikuara pas rishikimit buxhetor dhe në pajtim me vendimet e Qeverisë.

Në vitin 2015, MMPH ka përdorur 98% të buxhet final ose 38,126,445€ ngjashëm sikurse viti paraprak.

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike- realizimi ndaj buxhetit (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2015 Realizimi	2014 Realizimi	2013 Realizimi
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike:	**38,353,185**	**38,732,279**	**38,126,445**	**44,967,147**	**46,790,254**
Pagat dhe Mëditjet	1,834,195	1,819,712	1,817,788	1,613,389	1,464,098
Mallrat dhe Shërbimet	1,223,957	1,831,259	1,510,329	1,607,834	1,633,197
Shërbimet komunale	83,220	44,991	41,701	48,063	76,562
Investimet Kapitale	35,211,813	35,036,317	34,756,626	41,697,861	42,905,397

Shpjegimet rreth ndryshimeve në kategoritë buxhetore sipas shënimeve të paraqitura në PVF janë dhënë si në vijim:

Ndryshimet pas rishikimit të buxhetit në kategori ekonomike kanë ardhur si rezultat i realizimit të ulët të shpenzimeve dhe përshtatjes buxhetore nga ana e Ministrisë së Financave.

Në anën tjetër me kërkesën e MMPH-së dhe aprovimin nga Ministria e Financave është bërë transferi i mjeteve në vlerë 500,000€ nga projekti i shpronësimit te projekti tjetër kapital " Sistemi i ujërave të zeza dhe projekti i përmirësimit infrastruktural në lumin Bistrica në Prizren" i cili ishte në bashkëfinancim me Bankën Gjermane.

Tabela 3. Të hyrat vetjake – ekzekutimi ndaj buxhetit (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2015 Pranimet	2014 Pranimet	2013 Pranimet
Të hyrat vetjake	0	806,498	686,399	616,742	227,000
Totali	0	806,498	686,399	616,742	227,000

Të hyrat vetanake të realizuara prej 686,399€€ janë paguar në Buxhetin e Kosovës (BK) të cilat nuk shfrytëzohen nga ministria.

Çështja 5 –Klasifikimi jo i duhur i shpenzimeve- Prioritet i lartë

E gjetura Ne i kemi vlerësuar kontrollet e zbatuara nga menaxhmenti për ta dëshmuar procesin e duhur të regjistrimit të shpenzimeve. Në vijim kemi paraqitur rastet ku është evidentuar klasifikimi jo i duhur shpenzimeve:

- Tri pagesa në vlerë totale prej 29,717€ për punë shtesë për projektin "Memoriali për kontributin e gruas gjatë luftës 98-99" ishin bërë nga buxheti për mallra dhe shërbime përkatësisht kodi ekonomik "13460 shërbime tjera kontraktuese". Për më tepër, ky projekt ishte i planifikuar në PIP por në mungesë të mjeteve, projekti është realizuar nga mallrat dhe shërbimet;

- Në dy raste në vlerë totale 29,878€ për subvencionimin e Iniciativës qytetare "Ta Pastrojmë Kosovën" e bërë me vendim të Ministrit, shpenzimet janë realizuar nga kategoria e mallra dhe shërbimeve e që kjo përkrahje i takon kategorisë së subvencioneve. Në të njëjtën kohë kjo ishte bërë pa mbështetje të qartë ligjore; dhe

- Në kodin ekonomik të 13470 - Shërbime teknike, kemi vërejtur se në 9 raste në vlerë totale 3,368€ janë paguar kompensime më rastin e vdekjes së një anëtari të ngushtë të familjes së shërbyesit civil bazuar në nenin 22 të Rreg.33/2012. Bazuar ne ligjin e buxhetit për vitin 2015 shpenzimi i parave publike nga kategoria e shpenzimeve mallra e shërbime, nuk është i lejuar për pagesën e punonjësve

Rreziku Klasifikimi jo adekuat i shpenzimeve shkakton keq prezantim të shpenzimeve të ndodhura përkatësisht mbi/nën vlerësim të kategorive respektive.

Rekomandimi 5 Ministri duhet të sigurojë që shpenzimet e bëra të regjistrohen në kategori adekuate më qëllim të prezantimit të drejtë të shpenzimeve të ndodhura. Për më tepër gjatë planifikimit buxhetor të konsideroj kërkesat për buxhet edhe në kategorinë e subvencioneve, me qëllim të identifikimit të saktë të shpenzimeve

3.4 Prokurimi

Për vitin 2015, sipas planit të prokurimit janë paraparë: furnizime në vlerë prej 396,500€; shërbime 798,000€ si dhe punë në vlerë prej 5,042,940€. Rregullat e Prokurimit synojnë të sigurojnë se fondet publike përdoren në mënyrë transparente dhe efikase për të arritur vlerën për para. Korniza ligjore përcakton qartë të drejtat, detyrat dhe përgjegjësitë e të gjitha palëve të përfshira në menaxhimin e prokurimit. Kjo përfshin kërkesën për të ulur rrezikun e mos përfundimit të kontratave dhe ekzekutimin e tyre të dobët. Kjo arrihet përmes zbatimit të një regjimi të ndëshkimeve në lidhje me performancën e dobët si dhe përmes sigurisë së ekzekutimit.

Nga rishikimi i testeve, kemi identifikuar se disa kontrolle menaxheriale ndaj aktiviteteve të prokurimit nuk janë zbatuar me konsistencë. Sfidat në sistemin e prokurimit janë të ndryshme. Sipas të gjeturave të mëposhtme konstatojmë se si pasojë e mungesës së kontrollit adekuat gjatë aktiviteteve të prokurimit dhe dobësive në menaxhimin e projekteve kanë rezultuar mangësitë dhe dobësitë si në vijim:

Çështja 6 – Mos publikimi prokurimeve të planifikuara- Prioritet i lartë

E gjetura	MMPH nuk ka bërë publikimin e njoftimit paraprak të prokurimeve të planifikuara për realizim gjatë vitit ashtu siç kërkohet sipas nenin 39 të LPP-së. Kërkesa ka të bëjë me njoftimin paraprak të autoritetit publik i cili gjatë periudhës së ardhshme 12 mujore ka për qëllim dhënien e një ose më shumë kontratave të furnizimit, të shërbimeve apo të punëve, që vetëm ose bashkë, kanë një vlerë të parashikuar prej 500,000€.
Rreziku	Mos publikimi i njoftimit paraprak shkakton uljen e nivelit të reklamimit, transparencës dhe konkurrencës gjatë proceseve të prokurimit.
Rekomandimi 6	Ministri duhet të siguroje që rregullat mbi njoftimin paraprak të kontratave janë aplikuar me qëllim të reklamimit, transparencës dhe konkurrencës së mirëfilltë të procesit.

Çështja 7 - Mungesë e lejeve të ndërtimit – Prioritet i lartë

E gjetura Dy projekte të kategorisë së tretë[1] të cilat i financon MMPH, punimet janë duke u ekzekutuar ndonëse u mungon leja e ndërtimit.

Rreziku Mungesa e lejeve të ndërtimit shkakton që të mos ofrohet siguria që punët e ndërtimit të projekteve janë në cilësi dhe në pajtim më kërkesat e duhura qoftë mjedisore apo urbanistike.

Rekomandimi 7 Para çdo fillimi te projektit Ministri duhet të siguroj që Ministria paraprakisht është pajisur me leje ndërtimi sidomos kur behet fjalë për projekte të kategorisë së tretë.

Çështja 8 – Mos aplikimi i procedurave të hapura të prokurimit –Prioritet i lartë

E gjetura Në vitin 2013 ishte nënshkruar kontrata për "Ndërtimi i Memorialit për nderimin e kontributit të gruas gjatë luftës në Kosovë 98-99" në vlerë 120,000€. Pastaj në 2015, ministria ka vendosur ti zgjeroj investimet në këtë projekt për 29,717€. Realizimi i punëve është bërë me tre tender (sipas procedurës me kuotim të çmimeve) duke i shmangur procedurat e hapura të prokurimit.

Rreziku Ndarja e tenderëve sipas kuotimit të çmimeve ndikon në uljen e konkurrencës dhe transparencës si dhe në zvogëlimin e afateve kohore për aplikim në tender dhe vlerë më të dobët për para krahasuar më procedurat e hapura.

Rekomandimi 8 Ministri duhet të siguroj një rishikim të hollësishëm pse kërkesat specifike të prokurimit nuk janë adresuar për të gjitha prokurimet dhe të identifikojnë masat e duhura për të siguruar që këto dobësi të identifikuara janë adresuar në mënyrë efektive.

[1] Nëse ndërtesa është me rrezikshmëri të lartë ose me interes kombëtar njihen si ndërtime të Kategorisë III, Lista e llojeve të ndërtimeve të Kategorisë III gjendet në Shtojcën 1 të Ligjit Nr. 04/L–110 për Ndërtim

Çështja 9 - Mungesa e përcaktimit të sasive të planifikuara në kontratën kornizë-Prioritet i lartë

E gjetura

Në Tenderin/Kontratën kornizë me afat prej 36 muaj, për mirëmbajtjen dhe servisimin e automjeteve në vlerë 4,553€ për njësi, në specifikimet teknike nuk ishin planifikuar sasitë e njësive të tenderuara/kontraktuara[2]. Gjithashtu në këtë kontratë Operatori Ekonomik (OE) kishte ofruar çmime jo normalisht të ulëta. Sa për ilustrim kompania kishte tenderuar gomë vere për markën e veturave Landrover me çmim 2,95€, ftohës i brendshëm 2.30€, si dhe ftohës i motorit 2,25€ dhe të ngjashme. Kontrata ishte nënshkruar më datë 30.04.2015 ndërsa deklarata që OE qëndron mbrapa këtyre çmimeve ishte pranuar pas nënshkrimit të kontratës më 03.09.2015. Për këto produkte me çmime shumë të ulëta ministria nuk ka pasur kërkesa, megjithatë kjo mund të jetë e parealizueshme nëse do të ndodhin kërkesat e tilla.

Me rastin e ndërtimit të shtëpive të të riatdhesuarve vendimi për ndërtimin e dhe sasinë e tyre merret nga një komision në kuadër te Ministrisë se Punëve të Brendshme. Ndërsa ndërtimi dhe pagesa bëhet nga MMPH e cila nuk kishte planifikuar sasinë e shtëpive për ndërtim. Lidhur me këtë çështje ministria ka kërkuar interpretim nga KRPP-ja për mënyrën e prokurimit. E njëjta kishte dhënë rekomandim që kontrata të lidhet me OE për një shtëpi nga secili lloj i tyre. Megjithatë MMPH ka kontraktuar më shumë shtëpi për një lloj të tyre.

Rreziku

Mungesa e planifikimit të sasive të përafërta në kontrata si dhe vlerësimi i dobët i tenderëve rritë rrezikun e përfitimit të dobët të vlerës për para. Mos konfirmimi paraprak i çmimeve jo normalisht të ulëta rritë rrezikun për mosrealizimin e drejtë të kontratës apo anulimin e saj.

Rekomandimi 9

Ministri duhet të siguroj që më rastin e nënshkrimit të kontratave në të cilat aplikohet çmimi për njësi të bëhet edhe planifikimi i përafërt i sasive. Kjo do e mundësoj një pasqyrë më gjithëpërfshirëse lidhur me shpenzimet e kontraktuara.

[2] Sipas nenit 26 të rregullores së prokurimit publik A01, parashihet përcaktimi i sasive të planifikuara.

Çështja 10 - Vonesa në realizimin e projekteve dhe skadimi i sigurisë së ekzekutimit të kontratës – Prioritet i lartë

E gjetura Pjesa më e madhe e projekteve të MMPH-së janë projekte të viteve paraprake të bartura për realizim/pagesa në vitin 2015. Nga gjashtë projektet e analizuara katër[3] prej tyre nuk ishin realizuar sipas planit dinamik të përcaktuar në kushtet e veçanta të kontratës. Kjo ka ardhur si pasojë e hyrjes në obligime kontraktuale pa pasur mjete të mjaftueshme buxhetore apo lëvizjeve buxhetore për realizimin e projekteve. Nga po të njëjtat projekte që i kemi analizuar, tre prej tyre u është skaduar siguria e ekzekutimit ndonëse punët nuk kishin përfunduar ende.

Rreziku Vonesat në realizimin e planit dinamik, shkaktojnë vonesa në realizimin e projekteve dhe kanë efekt negativ mbi shpenzimin e buxhetit. Në anën tjetër, mos vazhdimi i sigurisë së ekzekutimit në rastet kur shtyhet realizimi i projekteve rrit rrezikun që punët të mos përfundohen sipas cilësisë dhe standardeve të kërkuara apo të dështoj kompletimi i tyre në tërësi.

Rekomandimi 10 Ministri duhet të ushtrojë kontrolle shtesë për të siguruar që procedurat kanë filluar me kohë dhe për çdo projekt të filluar paraprakisht të sigurohen mjetet financiare në përputhje me planin dinamik të realizimit të punëve.

Çështja 11 - Dobësitë në regjistrimin dhe pranimin e faturave – Prioritet i mesëm

E gjetura Në njëmbëdhjetë fatura të testuara për shpenzime kapitale, data e pranimit të tyre ishte regjistruar gabimisht në SIMFK. Diferenca kohore ishte deri në tre muaj. Megjithëkëtë, në të dhënat e raportuara në SIMFK pagesat janë evidentuar si të realizuara brenda 30 ditëve. Data e faturës duhet të llogaritet kur OE ka sjellë faturën në MMPH, përkatësisht data e protokollit dhe si e tillë duhet të regjistrohet në SIMFK.

OE i angazhuar në projektin "Ndërtimi i liqenit akumulues në lumin Iber" kishte sjellë dy fatura në periudha të ndryshme kohore për situacione të ndryshme të punëve të kryera dhe vlera te ndryshme por të cilat kishin numër të njëjtë fature.

[3] Projektin "Rregulli I kanalit të ujitjes Dubove-Dobrushe-Kashice-Saradran,Istog" data e kontratës 08.10.2014; plani dinamik 105 dite kalendarike,Projekti "Rregullimi i Lumit Drenica ne Drenas" data e kontratës 02.12.2014; plani dinamik 200 dite kalendarike,
"Projektet e ujësjellësit ne Drenas" data e kontratës 21.11.2014; plani dinamik 80 dite kalendarike;
Rehabilitimi i ujësjellësit dhe rritja e kapacitetit te ujit për 9 fshatrat e Kaçanikut; data e kontratës 25.03.2015; plani dinamik 214 dite kalendarike.

Rreziku Futja e të dhënave jo adekuate në SIMFK paraqet një raportim jo të drejt dhe nuk jep siguri se të njëjtat paguhen brenda periudhës së caktuar kohore. Në anën tjetër pranimi i faturave nga operatori ekonomik (OE) me numër të njëjtë rrezikon mos pagesën e tatimeve përkatëse apo mos deklarim të drejt të qarkullimit të OE.

Rekomandimi 11 Ministri duhet të siguroj forcimin e kontrolleve financiare rreth regjistrimit të faturave në SIMFK për të siguruar futjen e të dhënave të sakta në sistem.

3.5 Shpenzimet jo përmes prokurimit

3.5.1 Avancet, Komunalitë, Kontratat mbi vepër, etj

Në klasën e shpenzimeve të tjera ne i kemi përfshirë pagesat të cilat kalojnë jo përmes procedurave të prokurimit, dhe të cilat në SIMFK ekzekutohen përmes modulit të aprovimit. Testimet tona në këtë fushë nuk kanë nxjerrë në pah dobësi apo mangësi materiale, përveç pagesës së biletës për udhëtim zyrtar të një anëtari të kuvendit prej 478€.

Rekomandimi

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

3.5.2 Pagesat për shpronësim

Bazuar ne Ligjin për Shpronësimin e Pronës se Paluajtshme, MMPH është e autorizuar të bëjë kompensimin e pronës se paluajtshme pas kompletimit të dokumenteve të duhura për shpronësim. Pjesa dërmuese e këtyre shpenzimeve kishin të bënin me shpronësimet për rastin e ndërtimit të rrugëve por kishte edhe raste të shpronësimit të tokës për ndërtimin e objekteve qeveritare. Tokat që do shpronësohen janë të përcaktuara nga Ministria e Infrastrukturës ndërsa vlerën financiare e përcakton Ministria e Financave.

Çështja 12 - Mos aplikimi i softuerit për shpronësim – Prioritet i lartë

E gjetura MMPH ka në posedim softuerin për menaxhimin e të dhënave dhe pagesave për shpronësim në të cilin nuk ishin futur të dhëna që nga tetori i vitit 2014. Në zëvendësim të tij menaxhimi i të dhënave për shpronësim që nga aplikimi i palës deri të përgatitja e lëndës për pagesë bëhet në mënyrë manuale përkatësisht në Excel.

Rreziku Mbajtja e shënimeve në Excel nuk ofron siguri sa i përket informatave, sistemet manuale ekzistuese për sistemimin e informacionit mbi të dhënat për shpronësim mund të jenë subjekt i gabimeve apo manipulimeve të mundshme dhe nuk ofron siguri të informacionit.

Rekomandimi 12 Ministri duhet te siguroj aplikimin e sistemit aktual të SESH-it në një periudhë sa më të shkurtër kohore në mënyrë që të marrë siguri më të madhe për menaxhimin e procesit të shpronësimit përfshirë realizimin e shpenzimeve për shpronësim.

Çështja 13 - Vonesa në ekzekutimin e pagesave – Prioritet i lartë

E gjetura Në dy raste të shpronësimit, sipas vendimit të Kryeministrit të Kosovës, të nxjerrë në gusht 2011, thuhet që pagesa e kompenzimit duhet të bëhet brenda dy viteve ndërsa pagesa është realizuar në maj të vitit 2015.

Rreziku Mos realizimi i pagesave brenda afateve kohore pos faktit që ndikon në grumbullimin e obligimeve të papaguara nga viti në vit, dëmton interesat edhe ndaj palëve dhe rritë rrezikun e aplikimit të kamatave ndëshkuese për mos pagesat me kohë.

Rekomandimi 13 Ministri duhet të siguroj që kompensimi i pronave të shpronësuara paguhet sipas afateve kohore në përputhje me ligjin dhe vendimet përkatëse të qeverisë, si dhe realizimi i tyre të bëhet në mënyrë kronologjike bazuar në aplikimet e palëve.

3.5.3 Kompensimet (pagat dhe mëditjet)

Në bazë të ligjit të buxhetit dhe buxhetit të rishikuar në kategorinë e pagave dhe mëditjeve janë paraparë 293 punëtor ndërsa aktualisht janë të punësuar 288 punonjës.

Pagat dhe Mëditjet paguhen përmes një sistemi të centralizuar Niveli i kontrolleve në fushën e shpenzimit për Paga dhe Mëditje, MMPH i kryen përmes disa hallkave siç janë; autorizimi i listës së pagave, përshtatja e listës së pagave dhe reflektimi i ndryshimeve të ndodhura.

Rezultatet nga testimet tona ne këtë fushë janë si vijon:

Çështja 14 – Angazhimi me kontrata për shërbime të veçanta dhe ushtrues detyre për periudhë më të gjatë se tre muaj - Prioritet i lartë

E gjetura

Ndonëse MMPH kishte 15[4] pozita të lira në listën e pagave, kishte angazhuar punëtorë më kontrata për shërbime të veçanta mbi gjashtë muaj. Për këto angazhime, nuk janë ndjekur procedurat e duhura sipas rregullave të kërkuara, siç është procedurë e thjeshtëzuar e rekrutimit apo procedurë prokuruese.

Në shtatë raste MMPH ka mbajtur pozita me ushtrues të detyrës mbi tre muaj. Në dy prej tyre, ushtruesit e detyrës e zëvendësojnë stafin e suspenduar.

Rreziku

Angazhimi i punonjësve me kontrata mbi shërbimet e veçanta, minimizon konkurrencën dhe rrit rrezikun e angazhimit të personave jo të duhur në pozitat e caktuara. Mungesa e zbatimit të rregullave rrezikon që transparenca dhe niveli shërbimit të angazhuar të jetë jo i drejtë dhe i duhur.

Rekomandimi 14

Ministri duhet të siguroj zbatimin e rregullave gjatë proceseve të angazhimit të punëtorëve për shërbime të veçanta mos të kalojnë rregullat mbi gjashtë muaj dhe të bëj përpjekje që për pozitat e rregullta të punës, punëtorët të angazhohen përmes listës së pagave. Në anën tjetër të konsideroj që për periudhat e ushtrimit të pozitave më gjatë se tre muaj dhe që nuk ka pengesa ligjore të shpallë vendet e lira te punës duke i plotësuar ato pozita me punonjës të rregullt.

[4] pese pozita te lira sipas ligjit te buxhetit dhe 10 ne AQ te plotësuara me punëtor nga ZM

Çështja 15 – Pagesa e të punësuarve në programe joadekuate - Prioritet i mesëm

E gjetura Në zyrën e ministrit në bazë të buxhetit dhe rregullores së brendshme për organizimin e MMPH është paraparë stafi prej nëntë të punësuarve. Aktualisht zyra e ministrit në listën e pagave ka 20 të punësuar. Kompensimet janë bërë përmes listës së pagave nga programi për administratën qendrore.

Rreziku Planifikimi jo real i kërkesave buxhetore për të punësuarit sipas departamenteve, mund të ndikoj në mosarritjen e objektivave të organizatës si dhe të sjellë vështirësi gjatë realizimit të buxhetit.

Rekomandimi 15 Ministri duhet të siguroj që të behët një vlerësim real i nevojave të stafit nëpër departamente dhe ky numër të jetë i aprovuar sipas rregulloreve përkatësisht kërkesave buxhetore.

Çështja 16 - Afatet kohore për shqyrtimin e proceseve rekrutuese- Prioritet i lartë

E gjetura Në rekrutimin për pozitën Zyrtar i Meteorologjisë, shpallja e rekrutimit ishte bërë një muaj pas aprovimit nga MAP-i e që është në kundërshtim me rregulloren 02/2010 ku kërkohet shpallja rekrutimit të bëhet brenda pesë ditëve të punës pas aprovimit.

Në rekrutimin për pozitën e Inspektor i Mbrojtjes së Ujërave njoftimi për testim me shkrim dhe me gojë i kandidatëve ishte bëre dy muaj me vonesë ndonëse rregullorja e kërkon që një gjë e tillë të bëhet pesë ditë pune pas mbylljes së konkursit.

Rreziku Mos respektimi i afateve kohore për testimet mund të shkaktoj vonesa në rekrutim dhe ndërhyrje në proceset rekrutuese. Kjo mund të ndikoj edhe në transparencën e procesit të rekrutimeve.

Rekomandimi 16 Ministri duhet të siguroj një menaxhim më efikas në proceset e ardhshme të rekrutimit në mënyrë që të adresoj vonesat në fazat e ndryshme të procesit.

3.6 Të Hyrat (përfshirë të hyrat vetjake)

Të hyrat e realizuara nga MMPH në vitin 2015 ishin në vlerë 686,398€. Ministria realizon të hyra nga pesë departamente: Departamenti i Ujërave (DU), Departamenti për Mbrojtjen e Mjedisit (DMM), (AKMM), Departamenti i Banimit (DPHNB) dhe Agjencia Kadastrale e Kosovës(AKK).

Çështja 17- Planifikimi i nënvlerësuar i të hyrave – prioritet i lartë

E gjetura MMPH nuk kishte bërë një planifikim adekuat sa i përket mbledhjes së të hyrave për vitin 2015. Brenda dy departamenteve, mbledhja e të hyrave ishte disa herë më e lartë prej asaj që ishte planifikuar[5].

Rreziku Ndonëse MMPH nuk i shfrytëzon të hyrat e mbledhura mos planifikimi adekuat i tyre nuk bënë të qartë objektivat dhe arritjen e rezultateve të matshme.

Rekomandimi 17 Ministri duhet të marrë në konsideratë përfshirjen e planifikimit të të hyrave sipas njësive përkatëse dhe të sigurojë që planet buxhetore të të hyrave të bazohen në realizimet e mëparshme dhe përvojat e kaluara si dhe të kërkoj llogaridhënie efektive për nivelet e realizimit të tyre.

[5] AMMK ka planifikuar te mbledh 50,000€ ka realizuar 148,879.31€; DPHNB ka planifikuar 50,000€ ka realizuar 173,165.85€

3.7 Pasuritë dhe detyrimet

3.7.1 Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale

Sipas regjistrave kontabël të SIMFK për vitin 2015, vlera neto e pasurisë (mbi 1,000€), ishte: afër 166 milion€, ndërsa pasuritë nën 1,000€ janë shpalosur në vlerë 521,000€, ndërsa stoqet në vlerë 126,000€. Ne kemi rishikuar nëse procesi i regjistrimit dhe mënyra e mbajtjes së evidencës është në pajtueshmëri me kërkesat e Rregullores MF-nr. 02/2013, për menaxhimin e pasurisë jo financiare të organizatave buxhetore.

Çështja 18 – Regjistrimi i renovimeve si pasuri kapitale - Prioritet i lartë

E gjetura Agjencia Kadastrale e Kosovës shfrytëzon hapësirat e objektit të Arkivave të Kosovës dhe kishte bërë renovimin e objektit në vlerë totale prej 348,411€. Megjithatë, regjistrimi i këtij renovimi si pasuri kapitale në regjistrat e Ministrisë nuk ishte i drejtë pasi që regjistrimet si pasuri mund të bëhen vetëm nëse organizata ka pronësinë mbi atë pasuri.

Rreziku Regjistrimi i renovimit si investim kapital për një pasuri fikse që nuk është në pronësi të Organizatës Buxhetore ndikon në mbivlerësimin e pasurisë.

Rekomandimi 18 Regjistrimet e renovimeve si pasuri të organizatës në objekte duhet të bëhen vetëm në ato objekte ku pronar legjitim është organizata financuese, në të kundërtën është i pamundur kapitalizimi i këtyre shpenzimeve.

Çështja 19 – Mos bartja e Pronësisë tek Komunat për projektet e bashkë-financuara- Prioritet i lartë

E gjetura Projektet qe bashkë financohen me komunat e Kosovës vazhdojnë të figurojnë në regjistrat e pasurisë si investime në vijim përkundër faktit që disa prej objekteve veç janë të përfunduara. Ngjashëm ka ndodhur me blerjen e tri makinerive për komunat veriore, të cilat që nga fillimi i dhjetorit shfrytëzohen nga komunat përderisa figurojnë në regjistër të pasurive të Ministrisë.

Rreziku Mos bartja e pronësisë në kohë ndikon në mbivlerësimin e pasurisë së MMPH-së dhe në të njëjtën kohë në nënvlerësimin e pasurisë së Komunës përkatëse.

Rekomandimi 19 Ministri duhet të sigurojë që zyrtari i pasurisë të regjistroj si pasuri të ministrisë vetëm ato pasuri që në bazë të dokumenteve dëshmojnë se pasuria është në pronësi të OB, ndërsa për bashkëfinancimet që regjistrohen si investime në vijim të mbyllen në momentin kur objekti kompletohet dhe i dorëzohet përfituesit për shfrytëzim.

3.7.2 Trajtimi i të arkëtueshmeve

Llogarit e arkëtueshme për të hyrat për vitin 2015 të shpalosura në PVF janë 957,838€. Këto mjete janë nga taksat që duhet të paguajnë ofruesit e shërbimeve kryesisht të ujit. Në anën tjetër në listën e llogarive të arkëtueshme të shpalosura në PVF, janë edhe të arkëtueshmet kontingjente[6] në vlerë rreth 1,333,691€, të cilat ministria pret ti inkasojë. Ministria ka ndërmarrë hapa të ndryshëm në këtë drejtim ku gjatë vitit në vijim pritet të shihet progresi i arritur në këtë fushë.

Rekomandimi

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

3.7.3 Trajtimi i borxheve

MMPH-ja në vazhdimësi ka administruar procesin e trajtimit të borxheve, raportimi është bërë me kohë sipas kërkesave të Rregullës financiare 03/2013, në këtë kontekst ZKF në vazhdimësi ka kërkuar nga njësitë shpenzuese të MMPH-së që të jenë në kohë dhe sa më gjithëpërfshirës në kërkesat për raportim të borxheve. Megjithëkëtë, ende mbesin sfida në paraqitjen e obligimeve në raportimet vjetore. Totali i obligimeve të ministrisë për fund të vitit 2015 është shpalosur në vlerë prej 146 milion euro. Pjesa më e madhe e obligimeve të paraqitura është nga shpronësimet (mbi 145 milion euro).

Rezultatet tona nga kjo kategori janë si me poshtë:

Çështja 20 – Obligimet për shpronësime –Prioritet i lartë

E gjetura

Bazuar në vendimet e Qeverise vlera totale e obligimeve për shpronësimin e tokave për interes kombëtar për periudhën e viteve 2010-2015 arrijnë rreth 146 milion€. Sipas raporteve të zyrës për shpronësim, 35 milion[7]€ ishte vlera e aplikimeve për kompensim të cilat nuk kane arritur ende të procedohen për pagesë. Sipas shpjegimeve të paraqitura në PVF, buxheti i pamjaftueshëm ka qenë arsyeja e mos pagesës së obligimeve për shpronësime, ndonëse për vitin 2015 ishin aprovuar vetëm 28 milion euro për shpronësime. Rritja e obligimeve për shpronësime lidhet kryesisht me vonesat në procesimin e pagesave nga ministria dhe me mungesën e buxhetit për pagesën e tyre.

[6] Këtu përfshihen padit ndaj personave fizik dhe juridik për shkake të operimit të OE pa licencë apo leje mjedisore, për kompensim të dëmit nga persona fizik etj.
[7] Viti 2012-2015

Rreziku Çdo vendim i Qeverisë për shpronësim duhet të realizohet brenda dy viteve nga data e vendimit, shton rrezikun e aplikimit të kamatave ndëshkuese. Gjithashtu, kjo mund të shkaktoj implikime buxhetore të qeverisë për vitet vijuese.

Rekomandimi 20 Ministri duhet të sigurojë që kërkesat për planifikime buxhetore të bëhen në përputhje me kërkesat për shpronësime, si dhe kompensimet të bëhen në mënyrë kronologjike bazuar në datën e aplikimeve dhe afateve kohore përkatëse. Po ashtu, Rekomandojmë Ministrinë që së bashku me Ministrin e Financave të shqyrtojnë mundësinë dhe potencialin e bartjes së buxhetit për shpronësime në Ministrinë e Financave aty ku vendoset buxheti dhe vlera e shpronësim. Kryerja e planifikimit të buxhetit, vlerësimi i pronave dhe procesimi i pagesave nga niveli i njëjtë i vendimmarrjes do të mund të evitonte pengesat ekzistuese gjatë procesit të shpronësimit. Midis të tjerash, do të mundësonte planifikimin më të saktë të buxhetit karshi nevojave reale si dhe do ti kontribuonte trajtimit të ankesave eventuale rreth vlerësimit të pronave.

Çështja 21– Faturat e paguara janë shpalosur si obligime financiare-Prioritet i mesëm

E gjetura MMPH kishte shpalosur si detyrime në PVF për vitin 2015 tri fatura[8] në vlerë të përbashkët prej 2,565€, përkundër faktit që pagesa është kryer ndaj furnitorit.

Rreziku Mbi vleresimi i obligimeve në mënyrë jo të drejtë/jo reale rritë rrezikun që informatat e shpalosura ne PVF-të të mos jenë të besueshme. Kjo mund të shpie në devijim të buxhetit të shpenzimeve të parapara për vitin e ardhshëm.

Rekomandimi 21 Ministri duhet të sigurojë se të gjitha kontrollet lidhur me të dhënat e paraqitura në PVF janë duke funksionuar në menyrë që informatat e shpalosura të jenë të sakëta dhe të besueshme.

[8] MMPH: Fatura e datës 02.12.2015 ne vlere 970€ OE Indigo si dhe fatura e datës 09.12.2015 ne vlere 885€ OE Metropol si dhe një fature ne AKK e datës 01.12.2015 ne vlere 710€ OE Policia e Kosovës

Shtojca I: Qasja dhe metodologjia e auditimit

Përgjegjësitë e Auditorit dhe të atyre të ngarkuar me qeverisje janë dhënë në hollësi në Opinionin e përcaktuar në kapitullin 1.2 të këtij raporti.

Derisa rezultat kyç i punës sonë është opinioni i auditimit, ky raport pasqyron tërësinë e punës sonë me fokus të veçantë edhe në Çështjet e Qeverisjes përfshirë Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin. Kjo e fundit mbështetet në programin tonë të gjerë të auditimit të pajtueshmërisë të bazuar në rrezik.

Përmbledhja e përgjithshme ka për qëllim t'i nxjerrë në pah gjetjet kryesore të auditimit dhe veprimet kyçe për të cilat Ministri duhet të sigurojë se janë ndërmarrë për t'i adresuar dobësitë e identifikuara të menaxhimit/të kontrollit.

Raporti i detajuar ofron një përmbledhje të gjerë të të gjeturave tona të auditimit me theks të veçantë në përcaktimin e shkakut të të gjeturave të auditimit dhe në dhënien e rekomandimeve të përshtatshme për t'i adresuar ato. Për të qenë më i plotë, ne kemi përfshirë çështjet e identifikuara gjatë auditimit të ndërmjetëm aty ku ato kanë mbetur relevante. Të gjeturat tona janë definuar si:

Të prioritetit të lartë – Çështjet të cilat nëse nuk adresohen mund të rezultojnë në dobësi materiale në kontrollin e brendshëm dhe ku veprimi i marrë do të ofrojë mundësinë për përmirësimin e efikasitetit dhe efektivitetit të kontrolleve të brendshme; dhe

Të prioritetit të mesëm - Çështje të cilat mund të mos rezultojnë në dobësi materiale, por ku veprimi i marrë gjithashtu do të ofrojë mundësinë për përmirësimin e efikasitetit dhe efektivitetit të kontrolleve të brendshme.

Të gjeturat që mund të konsiderohen me prioritet të ulët do t'i raportohen veçmas stafit të financave.

Procedurat tona kanë përfshirë rishikimin e kontrolleve të brendshme, të sistemeve të kontabilitetit, teste të ndërlidhura substanciale si dhe aranzhimet e ndërlidhura të qeverisjes deri në atë masë sa që konsiderohet e nevojshme për kryerjen efektive të auditimit. Të gjeturat e auditimit nuk duhet të konsiderohen sikur përfaqësojnë një pasqyrë gjithëpërfshirëse të të gjitha dobësive që mund të ekzistojnë, apo edhe të gjitha përmirësimeve që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat që kanë operuar.

Shtojca II: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZAP

(e shkëputur nga ISSAI 200)

Forma e opinionit

147. Auditori duhet të japë një **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Nëse auditori, bazuar mbi dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë anomali materiale ose nuk arrin të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë anomali materiale, atëherë ai duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit sipas pjesës që flet për 'Përcaktimin e llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit'.

148. Nëse pasqyrat financiare të përgatitura sipas kërkesave të një kornize për prezantim të drejtë nuk arrijnë të japin një paraqitje të drejtë, auditori duhet të diskutojë çështjen me menaxhmentin dhe, varësisht nga kërkesat e kornizës së zbatueshme për raportim financiar dhe nga mënyra se si zgjidhet çështja, të përcaktojë nëse është e nevojshme të modifikojë opinionin e auditimit.

Modifikimet që i bëhen opinionit në raportin e auditorit

151. Auditori duhet të modifikojë opinion në raportin e auditorit në rast se, duke u bazuar në dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë gabime materiale, ose në qoftë se auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë anomali materiale. Auditorët mund të japin tre lloje opinionesh të modifikuara: opinion të kualifikuar, opinion të kundërt dhe mohim të opinionit.

Përcaktimi i llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit

152. Vendimi se cili lloj i opinionit të modifikuar është i përshtatshëm varet nga:

- Natyra e çështjes që i jep shkas modifikimit – d.m.th nëse pasqyrat financiare përmbajnë anomali materiale ose, në rast se ishte e pamundur për të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, mund të përmbajnë anomali materiale; dhe
- Gjykimi i auditorit rreth përhapjes së efekteve ose efekteve të mundshme që çështja ka në pasqyrat financiare.

153. Auditori duhet të japë një **opinion të kualifikuar nëse**: (1) pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se anomalitë, ose individualisht ose së bashku, janë materiale por nuk janë përhapur në pasqyrat financiare, ose (2) nëse auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, por arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë materiale por jo të përhapura.

154. Auditori duhet të japë një **opinion të kundërt nëse**, pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se anomalitë, ose individualisht ose së bashku, janë edhe materiale edhe të përhapura në pasqyrat financiare.

155. Auditori duhet japë **mohim të opinionit nëse**, pasi nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, auditori arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë edhe materiale edhe të përhapura. Nëse, pas pranimit të angazhimit, auditori bëhet i vetëdijshëm se menaxhmenti ka imponuar një kufizim të fushëveprimit të auditimit, për të cilin auditori konsideron se mund të rezultojë në nevojën për të shprehur një opinion të kualifikuar ose mohim opinioni mbi pasqyrat financiare, auditori duhet të kërkojë nga menaxhmenti ta heqë atë kufizimin.

156. Nëse auditori jep një opinion të modifikuar, ai duhet të modifikojë edhe titullin për të korresponduar me llojin e opinionit i shprehur. ISSAI 1705 jep udhëzime shtesë rreth gjuhës specifike që duhet përdorur kur jepet një opinion dhe për të përshkruar përgjegjësinë e auditorit. Ajo gjithashtu përfshin shembuj ilustrues të raporteve.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

157. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për të tërhequr vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka prova të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban anomali materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë një paragrafi të Theksimit të Çështjes në raportin e tij. Paragrafët për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohen vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

158. Një paragraf i Theksimit të Çështjes duhet:

- Të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- Të ketë titullin 'Theksim i Çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- Të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen;
- Të tregojë se opinioni i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

159. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për ta komunikuar një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që ta kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje Të Tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të Çështjes.

Shtojca III: Rekomandimet e vitit paraprak

Komponenti i Auditimit	Rekomandimet e dhëna	Të implementuara	Të adresuara por jo të implementuara	Të pa adresuara
Rreziqet domethënëse për PVF	R1 - Ministri duhet të sigurojë që të identifikohen masat e duhura për ti adresuar dobësitë në raportimin e pasurive në mënyrë që të mundësojë një prezantim të drejtë dhe të vërtetë të pasurive në PVF 2015.		Pasuritë në pronësi të AKK janë regjistruar. Derisa Renovimet dhe bashkëfinancimet nuk regjistruar drejt.	
Adresimi i rekomandimeve nga viti paraprak	R2 - Ministri duhet të sigurojë që plani i veprimit, i rishikuar, të përcaktojë saktë afatet kohore për adresimin e rekomandimeve të bëra nga AP, me stafin përgjegjës të identifikuar, duke u fokusuar fillimisht në fushat më të rëndësishme.		Progresi i arritur i rekomandimeve shihet në këtë tabelë.	
Konsolidimi i PVF	R3 - Ministri duhet ti trajtoj aranzhimet ekzistuese të llogaridhënies që i bëhen AKK-së për raportim, dhe të njetat ti avancoj për të përmirësuar cilësinë e menaxhimit finanaciar dhe të kontrollit në kuptimin e konsolidimit sa më të plotë.	X		
Realizimi i buxhetit	R4 -Ministri duhet të iniciojë një monitorim sistematik mbi performance buxhetore në baza mujore dhe të identifikojë dhe adresojë barrierat për të planifikuar më mirë nivelet e relizimit të buxhetit. Menaxhmenti duhet të kërkojë nga agjencitë që të raportojnë me kohë për sfidat dhe obligimet e tyre.		Ndonëse realizimi i buxhetit për vitin 2015 ishte 98%, megjithatë planifikimi i buxhetit ishte i pamjaftueshëm për shlyerjen e obligimeve të mëdha ndaj shpronësimeve.	

Klasifikimi i shpenzimeve	R5- Ministri duhet të siguroj një identifikim të drejtë të nevojave për blerje, reflektimin e tyre në planifikimet buxhetore duke i klasifikuar sipas planit kontabël. Për këtë qëllim, duhet të funksionalizohen kontrollet e brendshme për të siguruar që pagesat e aprovuara janë të planifikuara drejtë dhe në përputhje me buxhetin dhe planin kontabël.			Edhe pse ministria në raste specifike plotëson rekomandimin, megjithatë prapë ka raste tjerë që përsëriten (shih çështjen 1 në këtë raport)
Te Hyrat	R6-Ministri duhet të siguroj që të gjitha raportimet e njësive që gjenerojnë të hyra në MMPH të jenë të sakta, të harmonizuara dhe të plota me dëshmi përkatëse. Po ashtu mjetet e inkasuara te depozitohen ne llogaritë bankare në kohën e paraparë.	X		
	R7-Ministri duhet të krijoj dhe të sigurojë zbatimin sa më adekuat dhe efikas të në mënyrë që kompanitë komerciale të kryejnë obligimet që i kanë ndaj Ministrisë. Një alternative mund të ishte riprogramimi i borgjeve ndaj OE apo edhe rishikimi i tarifave për pagesë të përcaktuara me udhëzimin administrativ të ministrisë. Në anën tjetër, të gjitha kompanive te cilave ju ka skaduar licencat të jenë subjekt inspektimi dhe të vlerësohen situatat e tilla.	Ministria ka ndërmarrë masa adekuate, por efekti mbetet të shihet në periudhat e ardhëshme.		

Prokurim	R8- Ministri duhet të siguroj që bashkëfinancimet me komuna të jenë të mbështetura në bazën ligjore, ashtu që në financimin e projekteve mbi 50% të merr përsipër gjitha proceset e prokurimit dhe menaxhimit të projekteve. Në anën tjetër buxheti të realizohet për ato projekte për të cilat është planifikuar dhe në rast të ndryshimeve të bëhet aprovimi i tyre, në mënyrë që mos të ketë implikime te mundshme buxhetore.	Ministrija ka marre interpretim nga KRPP lidhur me kete qeshtje dhe ka vazhduar ta trajtoj sipas interpretimit ligjor. Sipas interpretimit organizatat buxhetore sipas marrveshjes se tyre mund te vendosin ne këto raste se kush duhet ti udhëheq procedurat e prokurimit.		
	R 9-Ministri duhet të siguroj që gjitha pagesat për punë dhe shërbime janë të mbështetura me raporte të pranimit të punëve apo shërbimeve.	X		
	R 10-Ministri duhet të siguroj kontrolle të duhura në proceset e menaxhimit financiar dhe, derisa nuk është nënshkruar kontrata të mos pranohen faturimet për pagesa në avanc.		Çështja specifike në rekomandim është plotësuar, derisa mbeten prapë dobësi në kontrolle të menaxhimit në sistemin e prokurimit (shih çështjet në nënkapitullin 3.4)	
	R 11-Ministri duhet të sigurojë se gjitha projektet e kontraktuara janë menaxhuar me kohë, në të kundërtën të aplikoj penalet.	X		
Paga dhe Mëditje	R 12- Ministri duhet të siguroj që puna jashtë orarit të planifikohet në mënyrë efektive dhe që kompensimet për punë jashtë orarit të arsyetohen bazuar në nevojat reale, dhe dokumentohen në mënyrën e duhur.	X		

Pasuritë	R 13- Ministri duhet të ndërmerr masa adekuate dhe me kohë në caktimin e komisioneve respektive dhe njëkohësisht të siguroj se ekzistojnë raportet për inventarizimin e pasurisë.	X		
	R 14-Ministri duhet të siguroj se të gjitha automjetet që i përkasin ministrisë janë regjistruar siç duhet si automjete zyrtare duke ndjekur kërkesat e UA mbi përdorimin e automjeteve zyrtare.	X		
Te Arketueshmet	R 15-Ministri duhet të konsiderojë marrjen e masave të menjëhershme për sa I përket marrëdhënies afariste me kompanitë e ujërave për të siguruar që bilanci i të arkëtueshmeve të ulet. Një alternativë e mundshme do të ishte ri programimi i borxheve.	Janë marrë masa si padi ndaj OE, është azhurnu UA për tarifat në për vitin 2016 priten të vlerësohen efektet.		
Obligimet	R 16- Ministri duhet të konsideroj çështjen e obligimeve të papaguara dhe të rishikoj gjitha mundësitë buxhetore apo tjera, që obligimet sidomos ndaj shpronësimeve të paguhen. Njëkohësisht, të vendos kontrolle më efikase që obligimet tjera të pa evidentuara të shpalosen në PVF në mënyrë që ato të jenë të përfisha në shuma të plota.		Obligimet totale (shpronësimet) janë në rritje. Obligimet e papaguara janë evidentuar, megjithatë ka raste kur faturat e paguara janë shpalosur si obligime të papaguara.	
Auditimi i Brendshëm	R17 Ministri duhet të siguroj se janë marrë masa shtesë nga komiteti i auditimit në drejtim të shtyrjes së implementimit të rekomandimeve të auditimit të brendshëm dhe atij të jashtëm, nga ana e menaxhmentit të ministrisë.	X		